VENDIM
Nr. 145, datë 26.3.1997

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMEVE FINANCIARE TË PROGRAMEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN PHARE/CROSS BORDER 1996 PËRKATËSISHT ME ITALINË DHE GREQINË

Me propozimin e Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim memorandumet financiare për programet e Bashkimit Europian PHARE/CROSS BORDER 1996 përkatësisht me Italinë dhe Greqinë, me një vlerë prej 20 milionë ECU.

2. Ngarkohet drejtori i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, ose çdo person tjetër i autorizuar prej tij, të nënshkruajë memorandumet financiare në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Ngarkohet PMU e programit CROSS BORDER pranë Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të menaxhojë të dy programet brenda afteve kohore të përcaktuara në këto memorandume.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino